



UNIVERSITETI I MITROVICËS 'ISA BOLETINI'

Programi mësimor i lëndës (Syllabusi)

Fakulteti:	Fakulteti Ekonomik	
Programi/Departamenti:	Biznes dhe Menaxhment/Specializimi: Menaxhment dhe Ndërmarrësi	
Niveli:	Bachelor	
Kodi i lëndës:		
Lënda:	Menaxhimi i Zinxhirit të Furnizimit dhe Logjistika	
Statusi i lëndës:		Zgjedhore
Semestri:		Veror
Fondi i orëve:	2+1	Sipas programit të aprovuar
ECTS:	4	Sipas programit të aprovuar
Orari/Salla		
Viti akademik:	Viti i III, Semestri i IV	
Mësimdhënës/e:	Prof. Ass. Dr. Filloreta Kunoviku Demiri	
Asistent/e:		
Kontaktet:	Mësimdhënës/e	Asistent/e
E-mail:	filloreta.demiri@umib.net	
Telefon:	+ 383 (0) 45 701 789	

PERMB

AJTJE

Aktivitetet e menaxhimit të logjistikës dhe zinxhirit të furnizimit kanë qenë gjithmonë jetike për organizatat e të gjitha llojeve. Kjo fushë menaxhimi, e cila përfshin aktivitete të ndryshme si prodhimi, transporti, inventari, magazinimi, blerja, trajtimi i materialeve, shitjet dhe shërbimi ndaj klientit, përfaqëson një sintezë të metodave dhe teknikave që vijnë nga fushat tradicionale të biznesit të financës, kontabilitetit, menaxhimit dhe marketingut, si dhe mjetet e vendimmarrjes së biznesit të ofruara nga kërkimi i operacioneve, statistikave dhe ekonomia.

Ky modul shqyrton sistemet logjistike që mbështesin furnizimin fizik të një firme me materiale të papërpunuara dhe gjysëm të gatshme, planifikimin dhe kontrollin e operacioneve, dhe shpërndarjen e produkteve ose shërbimeve deri te klientët përfundimtarë, me qëllim të arritjes së një avantazhi konkurrues të qëndrueshëm si dhe optimizimin e vlerës dhe performancës afatgjatë të firmës dhe të zinxhirit të furnizimit në tërësi. Fokusi do të jetë në hartimin, planifikimin, organizimin dhe kontrollin e aktiviteteve shoqëruese.

QËLLMI	Ky modul ka për qëllim që të përshkruajë rëndësinë në rritje të logjistikës dhe ndikimin e saj në të dyja kosto dhe shërbim në biznes dhe tregti, të inkorporojë dhe mësojë elementet kritike të menaxhimit të logjistikës dhe zinxhirit të furnizimit, të zhvillojë kritere dhe standarde për arritjen dhe përmirësimin e performancës së biznesit duke integruar dhe optimizuar procesin e logjistikës dhe zinxhirit të furnizimit si tërësi, të përshkruajë mënyrat e transformimit të kulturës biznesore nga punë funksionale në një proces të përgjithshëm - që shpie në rezultate, të përmbledhë vlerën e fokusimit në sistemet e logjistikës së biznesit të informacionit të cilat nxisin saktësinë dhe përmirësojnë vendimmarrjen në të gjitha nivelet e menaxhimit, të përfshijë një fokus domethënës në shkallën e ndryshimit që ndodh sot në biznes, dhe më konkretisht, në logjistikën e biznesit.	
ARRITSHMËRIA	❑ Me kompletimin e lëndës, studentët do të jetë në gjendje të: 1. <u>Përshkruajnë</u> menaxhimin e zinxhirit të furnizimit (MZF) dhe logjistikës, objektivat e MZF dhe kuptojnë zinxhirin bazë të furnizimit, 2. <u>Kuptojnë</u> se si zinxhirët e furnizimit dhe logjistika ndikojnë në konkurrencën, etikën dhe qëndrueshmërinë, 3. <u>Shpjegojnë</u> rolin që luajnë blerja, operacionet dhe logjistika në zinxhirin e integruar të furnizimit, 4. <u>Aplikojnë</u> aftësitë e të menduarit kritik në MZF, në strukturimin dhe analizimin e problemeve praktike, 5. <u>Demostrojnë</u> konceptin e përshtatjes strategjike ndërmjet strategjisë së zinxhirit të furnizimit dhe strategjisë konkurruese të firmës dhe si të arrihet ajo, 6. <u>Vlerësojnë</u> rëndësinë e rrjeteve të shpërndarjes dhe opsionet e ndryshme të disponueshme për projektimin e tyre, dhe 7. <u>Përdorin</u> pemët e vendimit për të vlerësuar vendimet e zinxhirit të furnizimit nën pasiguri.	
PROGRAMI	Javët	Tema
	Java - I	Përmbajtja dhe njohja me lëndën (Syllabusi)
	Java - II	Menaxhimi i Zinxhirit të Furnizimit: Hyrje
	Java - III	Roli i Logjistikës në Zinxhirin e Furnizimit
	Java - IV	Sigurimi i Materialeve dhe Shërbimeve
	Java - V	Prodhimi i Produkteve dhe Shërbimeve
	Java - VI	Menaxhimi i Kërkesës
	Java - VII	Kollokviumi i Parë
	Java - VIII	Menaxhimi i Porosive dhe Shërbimi ndaj Klientit
	Java - IX	Menaxhimi i Inventarit në Zinxhirin e Furnizimit

	Java - X	Shpërndarja - Menaxhimi i Përmbyshjes së Operacioneve
	Java - XI	Transporti - Menaxhimi i rrjedhës së Zinxhirit të Furnizimit
	Java - XII	Matja e Performancës së Zinxhirit të Furnizimit dhe Analiza Financiare
	Java - XIII	Teknologjia e Zinxhirit të Furnizimit - Menaxhimi i rrjedhave të informacionit
	Java - XIV	Ligjërata të përmblendhëse dhe Prezantimi i punimeve seminarike, projekteve, eseve, punës në teren, punës në grupe, etj.
	<u>Java - XV</u>	Kollokviumi i Dytë
LITERATURA	Literatura themelore: 1. C. John Langley, Robert A. Novack, Brian Gibson and John J. Coyle, (2020). <i>Supply Chain Management: A Logistics Perspective</i>, 2020 2. Martin Christopher, <i>Logistics and Supply Chain Management</i>, 2016. Literaturë plotësuese: 1. Patrick Jonsson, <i>Logistics and Supply Chain Management</i>, 2008. 2. Material nga ligjëratat	
METODOLOGJIA E MËSIMDHËNJËS	Në kuadër të këtij semestri janë të paraparë 15 Javë me nga 2 orë ligjërata dhe 1 ushtrime (seminare dhe diskutime), si dhe dy kollokfume të cilat mbahen brenda 15 ligjëratave të planifikuara (javën e 7 dhe 15). Studimet e rastit, projekte dhe detyrat e shtëpisë jipen pas çdo ligjërataje për studentët me qëllim që studentët të studiojnë dhe hulumtojnë në kohën e studimeve vetanake. Rezultatet nga aktivitetet e tilla paraqiten dhe diskutohen në javën vijuese. Studentët inkurajohen për të ndjekur zhvillimet aktuale ekonomike duke lexuar artikuj, gazeta ekonomike si dhe materiale të tjera relevante. Ata mund të identifikojnë çështjet/temat e radhës për diskutim nga lexime të tilla. Esetë e përgatitura nga studentët gjithashtu do të diskutohen si dhe inkurajohen prezantimet individuale dhe grupore.	

	Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit – 1 ECTS kredi = 25 orë)			
	Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
	Ligjërata	2	15	30
	Ushtrime	1	15	15
	Konsultime me mësimdhënësin/asistenten	1	15	15
	Kolokiume /seminare	2	2	4
	Detyra të pavarura			
	Koha e studimit vetanëk të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	6	18
	Përgatitja përfundimtare për provim	3	4	12
	Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final	/	/	/
	Projektet, prezantimet, etj	1	8	8
	Totali			102 orë= 4 ECTS
VLERËSIMI	Metodat e vlerësimit <u>Vlerësimi në %</u> Testi i –I-rë, me shkrim25% Testi i – II-të, me shkrim25% Aktiviteti në klasë10% Punime seminarike.....10% Povimi final30% Shkallët e notave : 50-me pak – nota 5 (pesë) 51-60 % - nota 6 (gjashtë) 61-70 % - nota 7 (shtatë) 71-80 % - nota 8 (tetë) 81-90 % - nota (nëntë) 91-100 % - nota (dhjetë)			
POLITIKAT AKADEMIKE	Studentët pritet të marrin pjesë rregullisht në ligjërata. Ata pritet gjithashtu të jenë aktiv në ligjërata, seminare dhe diskutimeve individuale dhe grupore. Profesori është në dispozicion për konsultime individuale. Studentët janë të detyruar për të lexuar literaturë para çdo ligjërata. Studenti është i obliguar të vijojë ligjërata dhe ushtrime. Plagjiatura dhe kopjimi në provime janë të dënueshme sipas statutit dhe rregulloreve të tjera të universitetit. Kodi e mirësjelljes vlen si për studentët ashtu edhe për mësimdhënësit.			

Mitrovicë

Bartës/e i/e lëndës:

Prof. Ass. Dr. Filloreta KUNOVIKU DEMIRI

19/12/2021

(Emër Mbiemër)

(Nënshkrimi)